

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	28	1021	2023
Nj. Org.	Numër	Shitja	Vlera
01-030/d	10	94	



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
**Komuna e Drenasit**  
 Zyra e Kryetarit



**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)**

**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 01.02.2023

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 1

Takim i rregullt / Redovni sastanak  Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 17

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*

*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da

Jo / Ne

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSb-së të mbajtur me datë 19.12.2022: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/01/Procesverbali-i-kksb-dhe-ftesa-e-dates-19-dhjetor.pdf>;
2. Plani i Punës së KKSb-së për vitin 2023;
3. Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSb-së gjatë vitit 2023;
4. Raport lidhur me punën e KKSb-së gjatë vitit 2022;
5. Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve;
6. Projekti "Integra" apo "Nxitja e rlintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë";
7. Të ndryshme

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

#### **Konkluzionet / Zaključci:**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb) ka mbajtur mbledhjen e rregullt të parën për vitin 2023. Mbledhjen e kryesoi nënkryetari i Komunës së Drenasit, Arben Shala, dhe koordinatorja Laureta Thaqi pajisi me materialet e nevojshme anëtarët për mbledhjen. Të pranishëm ishin 17 anëtarë të KKSb-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit.

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan ishin:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSb-së të mbajtur me datë 19.12.2022: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/01/Procesverbali-i-kksb-dhe-ftesa-e-dates-19-dhjetor.pdf>;
2. Plani i Punës së KKSb-së për vitin 2023;
3. Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSb-së gjatë vitit 2023;
4. Raport lidhur me punën e KKSb-së gjatë vitit 2022;
5. Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve;

6. Projekti "Integrn" apo "Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenusshëm lokalë në Kosovë";

7. Të ndryshme

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 19.12.2022 u miratua unanimisht, pa ndonjë koment nga anëtarët e KKSBB-së.

Për pikën e dytë, "Plani i Punës së KKSBB-së për vitin 2023", Koordinatorja e KKSBB-së, Laureta Thaqi prezantoi shkurtimisht planin e punës, si një orientim i punës së këtij këshilli në komunën e Drenasit si objektivat, aktivitetet, periudha kohore dhe synimet që tentohen të arrihen përmes këtij plani.

Duke u bazuar në nenin 9 'Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të KKSBB-së' pika 1.7 KKSBB duhet të hartoj Planin Vjetor të Punës dhe të njëjtin ta prezantoj edhe në Kuvendin Komunal për miratim. Pas miratimit, i njëjti do të publikohet në ueb faqe dhe do të shërbejë si udhërrëfyes për aktivitetet gjatë vitit 2023. Ky plani përcakton disa nga objektivat dhe aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit 2023, gjithmonë me synimin që shqetësimet e qytetarëve që adresohen të zgjidhen bashkë me përfaqësuesit institucional, organet e sigurisë e OJQ.

Në parim kjo pikë u përkrah nga të gjithë anëtarët e KKSBB-së dhe e votuan pa përjashtim, mirëpo, pati diskutim mbi atë të hartohet një plan me i detajuar me data për gjatë vitit se çka do të diskutohet.

Arben Nika fillimisht ngriti si çështje që ky plan të plotësohet edhe me detaje si organizimi fushatave, periudhat kohore të realizimit për secilën temë të sigurisë, në kuptimin e funksionimit më të mirë të KKSBB-së, mirëpo, edhe nënkryetari Shala theksoi se nuk duhet të dalim jashtë udhëzimit të MPB për Këshillat Komunal ku përcaktohet roli i KKSBB-së si një organ këshillues për çështje të sigurisë në komunën tonë dhe se ky plan është vetëm orientim në vija të trasha për punën e KKSBB-së. Pas diskutimeve, anëtarët e votuan unanimisht Planin e Punës për vitin 2023, me idenë që të plotësohet me një agjende të temave dhe datave kur planifikohen të ngritën si çështje.

3. Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSBB-së gjatë vitit 2023. Te kjo pikë u kërkua nga anëtarët që të gjitha mbledhjet të mbahen të enjteve. Me këto ndryshime, plani u votua unanimisht.

4. Raport lidhur me punën e KKSb-së gjatë vitit 2022; Te kjo pikë, koordinatorja e KKSb-së informoi të pranishmit shkurtimisht për punën e KKSb-së gjatë vitit të kaluar. Pika u votua unanimisht.

5. Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve; Te kjo pikë, zyrtari i DShPI-së, Afrim Prokshi informoi se fatmirësisht nuk ka pasur dëme në komunën tonë, përveç disa kërkesa për zhbllokim të pusetave.

6. Projekti "Integra" apo "Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokalë në Kosovë". Te kjo pikë, koordinatorja e projektit, Afije Veseli informoi se kryetari Lladrovcë dhe z.Valentin Hoxha drejtor në organizatën e "Socio Project", kanë lidhur memorandum bashkëpunimi për mbështetjen e të riatdhesuarve në komunën tonë. Është mbajtur sesioni informues dhe aplikimi për përfitim nga ky projekt. Projekti financohet nga Programi: "Perspektive Heimat" ose "Perspektiva Atdhe", në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - BMZ dhe zbatohet nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë, në partneritet e WEntrepreneur dhe mbështetur nga Arbeiter Samariter Bund – ASB.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSb-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

[Nënshkrimi]  
Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 28.02.2023

**Rekomandimet:**

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSb-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: [mpb.dsb@rks-gov.net](mailto:mpb.dsb@rks-gov.net)
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: [Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net](mailto:Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net)

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSb-së.